

## Kombetarja/ Shqipëria mberrin ne Qipro, per vendin e katert

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 14 Tetor 2013 14:18

---



Shqipëria ka mbërritur te dielen ne Qipro dhe eshte akomoduar ne nje nga hotelet me te mira te Nikosias. Kuqezinjte nen urdhrat e De Biazit do te zhvillojne pergatitjet e fundit para ndeshjes qe do te luhet te marten. Teksa matematika na la jashte cdo mundesie per te arritur nje nga tre vendet e para ne grupin E, kombetarja Shqiptare luan ne Qipro shansin e vet per te sulmuar vendin e 4. Ndaj skuadres me te dobet te grupit, djemte e de Biazit kane nje mision per te permbushur edhe pse eshte shume larg atij qe ne pretendonim nje muaj me pare. Ne gare per kete pozicion jane tre skuadra, Islanda, Sllovenia dhe Norvegjia. Duke qene se nga Norvegjia e vendit te katert na ndan nje pike, atehere matematika na lejon te enderrojme per vendin e katert ne grup.